



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 58/12
Prishtinë, më 11.04.2012, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli, Kushtrim Aliu (praktikant), Dafina Hasanmetaj (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Lumniye Krasniqi dhe Suzan nga IGJK, Naile Krasniqi, Arben Bilalli nga KPM, Ismet Krasniqi Sekretar i Kuvendit, Ramadan Islami, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura të komisionit më 28.03.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar të Institutit Gjqësor të Kosovës për vitin 2011;
5. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2011;
6. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011;
7. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-60 për Mbeturinat me Raportin me amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
8. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-106 për Teatrot me Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;
9. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-96 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, me Raportin me amendamente të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura të komisionit më 28.03.2012

Procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Kryetarja, njoftoi arsyeja pse e kemi radhitur përsëri për shqyrtim raportin me amendamente për këtë projektligj është pasi që komisioni për legjislacion, ka pasur disa rezerva në amendamentin e propozuara. Gjatë kësaj kohe kemi diskutu edhe me kryetarin e komisionit për legjislacion dhe është angazhuar edhe Haxhi Gashi nga USAID që të punojë në harmonizimin e këtij projektligji me ligjin për gjykata, sepse problemi ka qenë tek divizioni fiskal në kuader të gjykatës themelore të Prishtinës, që i lehet tash kompetencë për shqyrtimin e lendeve tatimore, të cilat më pare kanë shku ne bordin për shqyrtimin e ankesave në administratën tatimore.

Haxhi Gashi, theksoi se komisionit për legjislacion e ka kundërshtuar raportin e amendamenteve për shkak se ligji ka themelu një divizion në kuader të gjykatës themelore për çështje fiskale dhe ajo është në kundërshtim me ligjin për gjykata sepse vetëm këshilli gjyqësor mund ta themeloj atë divizion. Ne e kemi evituar këtë pengesë, e kemi ndryshuar qëllimin e ligjit dhe kemi kriju mundësin që divizioni të mbetet por është bërë referenca që divizioni të themelohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me ligjin për gjykata. Komisioni për legjislacion ka kundërshtuar edhe një pikë tjetër në cilën është then që nuk ka drejtë me shku lënda në gjykatë por duhet të shkoj në bord në procedura administrative në shkallën e dytë. ne me këtë nuk jemi pajtuar sepse vetë ligji i gjykatave prej 1 janarit 2013 e ndryshon procedurën të çështjeve administrative e themelon departamentin administrativ. Për më shumë ligji special mund të krijoj procedura te reja.

Kryetarja, amendamenti 1 është njëjtë sikur e keni miratuar në komision. Me amendamentin 2 është ndryshue qëllimi i këtij projektligji. Ky ndryshim u miratua njëzëri. Në amendamentin 4 është bërë një përmirësimin e divizionit fiskal dhe është thënë se divizioni i themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me ligjin për gjykatat dhe që vepron në kuader të departamentit për çështje administrative të gjykatës themelore administrative të Prishtinës – Ky ndryshim u miratua njëzëri.

Amendamenti 5, 6, 7, 8, 9, 10 është i njëjtë. Të amendamenti 11 pika 3 ka qenë ndaj ktu tash është e shënime kundër vendimeve të divizionit fiskal- të gjithë e përkrahen. Të amendamenti 13 e keni një plotësim këtu dmth është parashtruesi i ankesës edhe janë sqarue disa terma në procedurë ankimore këtu- të gjithë i përkrahen ndryshimet në këtë amendament.

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Miratohet raporti me amendamente me ndryshimet e propozuara për Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe raporti procedohet për shqyrtim në komisionin për legjislacion dhe në procedurat e mëtutjeshme në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011

Suzana, raportoi se nga buxheti fillestar deri te buxheti përfundimtar kanë ndodhur disa ndryshime, njëri ndryshim ka ndodhur me vendimin e qeverisë për reduktimin e alokimeve që institutit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve iu kanë marr 6% të buxhetit në vlerë prej 21.666, ndërkaq një vendim tjetër që është aprovuar nga qeveria ka pasur të bëjë me kërkesën e ministrisë së drejtësisë për transferin e mjeteve nga buxheti i saj në buxhetin e institutit gjyqësor. Shpenzimet në raport me alokimet në kuader të pagave dhe mëditjeve kanë qenë 92.4%, mallrat dhe shërbimet në raport me alokimet kanë qenë 99.5% dhe shpenzimet komunale në raport me alokimet kanë qenë 69.8%. Në kuadër të mallrave dhe shpenzimeve përfshihen kryesisht shpenzimet e përfaqësimeve, shpenzimet e marketingut, qiraja, mirëmbajtja e shërbimeve të regjistrimit dhe sigurimit, derivatet dhe lëndët djegëse, blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve, moblije dhe paisje, shpenzimet e shërbimit apo trajnimit, shërbimet e telekomunikimit, shpenzimet e udhëtimit. Këto shpenzime në krahasim me vitin e kaluar janë më të vogla pos shpenzimeve të trajnimit dhe shpenzimeve të qerasë janë më të larta. Instituti kanë gëzuar mbështetje të madhe edhe nga donatorët.

Salih Asllanaj, theksoi se shqetësim paraqesin shpenzimet e qerasë , dhe pyeti a keni gjet ndonjë mundësi me kalu në një objekt ku qeraja është më lirë?

Hasime Krasniqi, theksoi se shpenzimet për derivate dhe lëndët djegëse, paraqesin rritje krahasuar me vitin 2009-2010, lidhur me këto shpenzime kërkoi një arsyeshmëri? Po ashtu edhe shpenzimet për qira konsiderohen të larta, a mund të zhvendoseni në ndonjë objekt tjetër?

Suzana, shpenzimet e qerasë paraqesin shqetësim edhe por deri me tani nuk na është ofruar ndonjë zgjidhje për vendosje në ndonjë objekt shtetëror, por në krahasim me vitin 2010 edhe shpenzimet e qerasë janë pak më të vogla. Sa i përket pyetjes tjetër për derivate dhe lëndë djegëse është e njëjta kontratë është çmimi i njëjtë por nevojat kanë qenë më të mëdha se çdo herë kemi pas trajnime.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2011

Jelena Bontić, sqaroi se grupi punues ka mbajtur një takim ku është shqyrtuar raporti financiar i KPM-së dhe është kërkuar që të ofrohet informata shtesë për shpenzimet e KPM-së për vitin 2011. Krahas kësaj janë edhe disa pyetje shtesë. KPM, ka filluar të punojë me pesë punëtor, ndërsa sipas planit të buxhetit është paraparë deri në shtatë punëtorë, në qfarë mënyre është harxhuar 100% e buxhetit për paga? Pyetja e dytë më intereson të dijë shpenzimet e udhëtimit të cilat janë dukshëm më të larta, në cilën kategori i keni huazuar mjetet për keto shpenzime. Dua të na sqaroni dhe shpenzimet tjera si për telefon, e cila është shumë e lartë poashtu sqarimet shtesë vlen për kategorinë e lëndëve djegëse, shpenzimet e energjisë elektrike të larta kur shifet se keni pasur edhe shpenzime të lëndëve djegëse për gjenerator.

Naile Krasniqi, sqaroi se KPM-ja për vitin 2011 ka pasur të planifikuar 31 punëtor. Përkundër ndryshimeve në lëvizjet e punëtorëve – staf civil në fund të vitit, punëtorët kanë qenë në numrin e planifikuar. Sqarimet për pesë punëtor ana në fakt janë anëtar të këshillit kanë munguar gjatë vitit 2011 dhe ata janë të emëruar nga Kuvendi dhe nuk paguhën nga linja paga dhe mëditje dhe paguhën nga linja shërbime intelektuale, edhe

nga bordi për ankesa të cilet kanë marr pagesën çdo muaj nga kjo linjë. Në vitin 2009 ne fund të vitit 2010 është implementuar projekti që e kemi marr përmes IPA, që është një sistem i sofistikuar i monitorimit dhe janë shtuar pajisje më tepër monitoruese që kërkojnë shfrytëzim të rrymës më tepër.

Sali Asllanaj, vlerësoi se shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë shumë të larta, të cilat janë të ndara në dy nënkategori, njëra shpenzime jashtë vendit, tjetra shpenzime të akomodimit edhe pse janë njësoj, pse janë kaq të larta këto shpenzime? Sa i përket justifikimit për shpenzimet për paga dhe mëditje, që sqaruat se janë paguar dy anëtarë të bordit për ankesa dhe dy të këshillit, sa ka qenë rroga e tyre? Prej pozicionit mallra dhe shërbime nuk lejohet pagesa e të ardhurave.

Hasime Krasniqi, një pyetje konkrete nga cili zë buxhetor janë rritur shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit? Po ashtu edhe tek blerjet tjera të mallrave dhe shërbimeve janë tejkaluar?

Latif Gashi, të njëjtat shqetësime të anëtarëve i kam edhe unë, por në shpenzimet e rritura, kjo ka ndodhur për shkak të organizimit të punëtorisë në Ohër dhe Durrës, pjesë e së cilës kam qenë edhe unë, i deleguar nga komisioni, ku është diskutuar për strategjinë e digjitalizimit, përkatësisht projektligjin e KPM-së. Megjithatë sugjeroi që herave tjera takimet të mbahen brenda vendit.

Kryetarja, nga raporti shifet se kemi tejkalim të shpenzimeve të disa pozicioneve, psh kemi tejkalimin e tek pagat dhe mëditjet që duhet me na dhanë një sqarim konkret. Shpenzimet e udhëtimit më të larta se sa kanë qenë të planifikuara. Gjithashtu tejkalim kemi tek shpenzime kategoria blerja e mallrave dhe shërbime-furnizim për zyrë, kjo është një lloj shkelje e ligjit, prandaj kërkohet sqarime për tejkalimin e këtyre shpenzimeve nga ato të planifikuara.

Naile Krasniqi, sqaroi se arsyeja e tejkalimit të shpenzimit për mallra dhe shërbime ka të bëjë me rritjen e pagave për 30% për shërbyesit civil, ku në fillim nuk është planifikuar me buxhetin e KPM-së dhe pas bisedave me MF-në e kemi realizuar këtë të drejtë dhe kjo ka ndikuar në rritjen e buxhetit. Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë si rezultate të organizimit të një punëtorie në Ohër ku janë ftuar përfaqësues të tri komisioneve të Kuvendit dhe në këtë punëtori ka marrë pjesë vetëm stafi menagjues i KPM-së, dhe kjo rritur buxhetin në këtë kategori që nuk ka qenë i planifikuar. Po ashtu në qershor në kuadër të shqyrtimit të PL për KPM dhe RTK-në, është mbajtur një punëtori nga grupi punues qeveritar në Durrës, dhe KPM-ja së bashku me transmetuesin publik më RTK-në kanë bërë shpenzimet gjysmë për gjysmë të asaj punëtorie. Në shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit kanë ndikuar edhe trajnimet që janë bërë për stafin. Po ashtu pjesëmarrja e dy anëtarëve të KPM- në takimet e rjetit evropian i rregullatorit mediteran ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve.

Arben Bilalli, lidhur me shpenzimet për blerjet për furnizime për zyrë, ka të bëjë me financimin e projektit që kemi menduar që komplet financimi do të jetë prej BE-së, dhe furnizimi i tyre ka qenë një kusht për shkak se pajisjet që janë vendos në disa pika të PTK-së ku merret signali prej gjithë Kosovës edhe na është kërkuar një shtesë për të bërë sigurimin e tyre, prandaj është bërë investimi shtesë.

Kryetarja, theksoi se i ka edhe dy pyetje, për qfarë i keni të parapara me Memorandum të Mirëkuptimit mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve dhe sa përqind të mjeteve nga të hyrat vetanake i realizoni? Dhe çështja tjetër ka të bëjë shumën prej 450.000 euro të ndara për ndërtim të objektit, dhe i keni harxhuar vetëm 8.000 euro, nuk po di për çka i keni hargjuar ato 8.000 euro mirëpo në suficit kanë shku 440.000 euro është një shumë mjaftë e madhe?

Xhevdet Neziraj, për të hyrat vetanake janë realizuar vetëm 65%, përse nuk janë realizuar në shumën e planifikuar, ku ka qenë pengesat që nuk janë realizuar shumat totale?

Latif Gashi, pasi që në raport thuhet se të hyrat e planifikuara nga licencat janë realizuar vetëm 65%, a është si pasojë e mosfunksionimit të bordit apo cila është pengesa që nuk janë realizuar edhe 35% tjera të planifikuara?

Naile Krasniqi, në pyetjen si janë shfrytëzuar mjetet e ndara me Memorandum të Mirëkuptimit, sqaroi se kemi pas angazhim të konsulentëve, mirëpo kemi pas edhe linjën tjetër të hulumtimit që të behet hulumtimi i tregut televiziv i mediave në Kosovë dhe është bërë hulumtimi për shikueshmërinë e mediave dhe penetrimit të mediave dhe realizimit nga ty licencat është bërë vetëm 65%. Kemi pas kërkesë që të realizohet objekti i KPM-së dhe mjetet janë ndarë edhe që nga fillimi i vitit 2011, kanë filluar diskutimet me Kuvendin komunal të Prishtinës për ndarjen e parcelës për ndërtimin e objektit dhe me udhëzimin e tyre është realizuar projekti ideor për projektin kapital prej 450.000 eurove dhe në korrik kemi marr përgjigje negative nga komuna e Prishtinës për ndarjen e parcelës dhe jemi udhëzuar nga ta që ne ti kontaktojmë agjensionin kosovar të pronës dhe të iu kërkojmë atyre që mos shitet pronat apo privatizohet dhe si rezultat mjetet për këtë projekt kanë mbetur në suficit.

Pas diskutimeve, Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), një Kundër (Jelena Bontic), asnjë Abstenim dhe të gjithë nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2011.

6. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011

Komisioni njëzëri votoi për shtyrjen e pikës së gjashtë të rendit të ditës për një mbledhje tjetër të komisionit.

7. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-60 për Mbeturinat me Raportin me amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja, njoftoi se në bazë të analizës së bërë projektligjit dhe amendamenteve të komisionit funksional, nuk është identifikuar se projektligji dhe amendamentet përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë kostot shtesë buxhetore.

8. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-106 për Teatrot me Raportin me amendamente të Komisionit Funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja, njoftoi se në bazë të analizës së bërë projektligjit, nuk është identifikuar se projektligji përmban kosto shtesë buxhetore. Është një i komisionit funksional - amendamenti 15 që është propozuar të fshihet paragrafi 7 i nenit 20 të projektligjit, ku është sqaruar e shkruar që zbatimi i këtij ligji mund të bëhet varsishtë nga situata fiskale dhe buxhetore. Propozojë që komisioni të rekomandoj heqjen e këtij amendamenti dhe të mbetet siç ka qenë në projektligj.

Pas diskutimeve, me një Abstenim (Hykmete Bajrami), asnjë kundër dhe të gjithë të anëtarët tjerë Për, komisioni nxori

REKOMANDIM

1. Projektligji nr.04/L-106 për Teatrot, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, për Projektligjin nr.04/L-106 për Teatrot , nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 15.

Amendamenti 1

Amendamenti 15 i komisionit funksional, **të fshihet**

9. **Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-96 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, me Raportin me amendamente të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale**

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Mbledhja përfundoi: 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj